



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 57

Datë: 03.12.2020. Ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.50 dhe 51/2020

2. Shpallja dhe miratimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës e Veriut, të mbajtura më datën 29 nëntor 2020.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përhëndetje. E hapi mbledhjen e 57-të. Ju lutem, a ka dikush vërejtje, ndonjë propozim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Në vazhdim, u miratua procesverbalet nga mbledhjet nr.50 dhe 51/2020.

2. Shpallja dhe miratimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të mbajtura më datën 29 nëntor 2020.

Valdete Daka: Vazhdojmë...! Ju njoftoj se mbas përfundimit të të gjitha procedurave, në vendvotime dhe në QNR, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpallë rezultatet përfundimtare për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës së veriut, të mbajtura më 29 nëntor 2020.

1.Statistikat për komunën e Podujevës:

1. Numri i zgjedhësve të regjistruar, ka qenë: 87.805 votues.
2. Numri i zgjedhësve që kanë votuar ën cdo VV, ka qenë: 34. 873 votues.
3. Numri i zgjedhësve që kanë votuar me kusht apo me postë, ka qenë: 919.
4. Pjesëmarrja e përgjithshme e qytetarëve në proces zgjedhor, ka qenë: 40.76%.

2.Statistikat për komunën e Mitrovicës së veriut:

1. Numri i zgjedhësve të regjistruar, ka qenë: 23. 316 votues.
2. Numri i zgjedhësve që kanë votuar ën cdo VV, ka qenë: 8. 874 votues.
3. Numri i zgjedhësve që kanë votuar me kusht apo me postë, ka qenë: 172
4. Pjesëmarrja e përgjithshme e qytetarëve në proces zgjedhor, ka qenë: 38.08%.

1. Rezultatet e subjekteve partiake në komunën e Podujevës:

1. PDK, me kandidatin Naim Fetahu, ka 4.341 vota, ose 12.3%.
2. LDK, me kandidatin Nexhmi Rudari, ka 12. 627 vota, ose 35. 8%.
3. LVV me kandidatin Shpejtim Bulliqi, ka marrë 18. 286 vota, ose 51. 9%.

2. Rezultatet e subjekteve partiake në komunën e Mitrovicës së veriut:

1. LVV, me kandidatin Erden Atiq, ka 351 vota, ose 4.0 %.
2. Kandidati i pavarur Dushan Millunoviq, ka 256 vota, ose 2.9%.
3. Lista serbe me kandidatin Milan Radojeviq, ka marrë 7.916 vota, ose 89. 5 %.
4. PDK, me kandidatin Florent Azemi, ka marrë 318 vota, ose 3.6 %.

Anëtarët e KQZ-së, vec e vec, miratuan në mënyrë unanime këto rezultate.

Valdete Daka: Pra, këto janë rezultatet përfundimtare. Kushdo që ka ndonjë ankesë në lidhje me rezultatet përfundimtare, këtë mund ta bëjë në PZAP, nga ky moment deri nesër në të njëjtën kohë...

Të ndryshme !

